



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 208, Datë 27.09.2018

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SA’GA MAT” SH.P.K., NR. 247, SERIA PV14K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR. 92, DATË 16.10.2014, PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC-ET: “GERMANI 1” ME FUQI 1200 KW, “GERMANI 2” ME FUQI 1680 KW, “GERMANI 3” ME FUQI 1290 KW, “GERMANI 4” ME FUQI 810 KW, ME FUQI TOTALE 4980 KW

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 43 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; nenit 10 pika 3 dhe nenit 15 të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016; nenit 15 dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Enërgjisë në mbledhjen e tij të datës 27.09.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “SA’GA MAT” sh.p.k., nr. 247, Seria PV14K, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1” me fuqi 1200 kW, “Germani 2” me fuqi 1680 kW, “Germani 3” me fuqi 1290 kW, “Germani 4” me fuqi 810 kW, me fuqi totale 4980 kW,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SA’GA MAT” shpk, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 567, datë 03.09.2018, ka kërkuar modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.
- Shoqëria “SA’GA MAT” shpk, është mbajtëse e Licencës me nr. 247 Seria PV14K, për prodhimin e energjisë elektirke nga HEC-et “Germani 1” me fuqi 1200 kW, “Germani 2” me fuqi 1680 kW “Germani 3” me fuqi 1290 kW “Germani 4” me fuqi 810 kW, me fuqi totale 4980 kW, dhënë me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 06.10.2014.

- Kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i optimizimit të skemës hidroenergjitike, si dhe për përmirësimin e të gjithë parametrave duke pakësuar numrin e HEC-eve në 2, me ndërtimin e objektit konkret “Germani 1” dhe “Germani 2”.
- MIE me shkresën nr. 415/12 Prot., datë 27.04.2017, drejtuar shoqërisë ”SA’GA MAT” sh.p.k., për dijeni AKBN, ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar, të ndryshuar të HEC-eve “Germani 1” dhe “Germani 2”.
- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “SA’GA MAT” sh.p.k. dhe MIE, kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 618 Rep. dhe nr. 203 Kol., datë 13.06.2017, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës “BOT”, (Ndërtim Operim, Transferim) për ndërtimin e hidocentraleve “Germani 1”, “Germani 2”, “Germani 3”, “Germani 4” dhe “Germani 5”.
- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “SA’GA MAT” sh.p.k., në bazë të “Rregullores për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, rezultoi i plotësuar pjesërisht si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Neni 9, pika 1:

- gërma “a” (të dhënat për aplikim) - Plotësuar;
- gërma “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) - Plotësuar;
- gërma “c” (të dhëna për aplikuesin) - Plotësuar.

Neni 15 pika 4:

- Gërma “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës – Plotësuar;
- Gërma “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës. Vendimi i datës 31.08.2018 – Plotësuar;
- Gërma “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. **Plotësuar pjesërisht.** Është depozituar në ERE nga subjekti, shkresa e MIE nr.415/12, datë 27.04.2017, “Miratohet projekti i zbatimit i ndryshuar, i HEC-eve “Germani 1 dhe Germani 2” si dhe kontrata shtesë e Koncesionit me nr. 618 Rep., nr. 203 Kol., datë 13.06.2017, e lidhur midis MIE dhe “SA’GA MAT” sh.p.k në vijim të miratimit por nuk janë depozituar të rifreskuara Leja Mjedisore, Leja e Përdorimit të Ujrave si dhe Miratimi i OST pas ndryshimeve që ka sjellë ndryshimi i projektit të zbatimit dhe shtesa në kontratën e koncesionit të sipërcituar;
- Gërma “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licensuarit sipas legjislacionit në fuqi - Plotësuar;
- Gërma “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE – Plotësuar;

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera, (Neni 15 pika 4 gërma “c”), do të njoftohet subjekti që ti paraqesë ato brenda afateve që përcakton “*Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënie, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike*”,

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë “SA’GA MAT” shpk, nr. 247, Seria PV14K, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 92, datë 16.10.2014, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Germani 1” me fuqi 1200 kW, “Germani 2” me fuqi 1680 kW, “Germani 3” me fuqi 1290 kW, “Germani 4” me fuqi 810 kW, me fuqi totale 4980 kW. Modifikimet do të rezultojnë si me poshtë:
 - Kudo në licencë ku shprehet “*Hydrocentralet “GERMANI 1” me fuqi të instaluar 1200 kW, “GERMANI 2” me fuqi të instaluar 1680 kW, “GERMANI 3” me fuqi të instaluar 1290 kW, “GERMANI 4” me fuqi të instaluar 810 kW*”, do të zëvendësohet me “*Hydrocentralet “GERMANI 1” me fuqi të instaluar 4800kW dhe “GERMANI 2” me fuqi të instaluar 1500kW*”.
 - Fuqia totale e instaluar 4350kW, zëvendësohet me shprehjen, “fuqia totale e instaluar 6300kW”;
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI